



MARRËVESHJE E BASHKËPUNIMIT

NDËRMJET

KOMUNËS SË DRENASIT

dhe

"MOBILEZONE"

Datë: 13.06.2019

Nr. prot. 01-400-32563

"MobileZone", me pronar z. Abdullah Zeneli, ka ndarë bursa për studentët e Komunës së Drenasit, në këtë kontest Komuna e Drenasit në bashkëbisedim me përfaqësuesin e kompanisë së lartë përmendur, kanë rënë dakord për një marrëveshje bashkëpunimi, si më poshtë:

Neni 1

Qëllimi

1. Kjo marrëveshje ka për qëllim që të ndahet një bursë për studentët e Komunës së Drenasit, të shprehur më vullnetin e mirë dhe gatishmërinë për bashkëpunim, me qëllim të ndihmesës së studenteve për t'ia lehtësuar kryerjen e studimeve.

Neni 2

Detyrat dhe Përgjegjësitë e Kompanisë

1. Kompania e merre për obligim që në bazë të kriterëve të konkursit me nr. 09-400-59676, të datës 05.10.2018, për ndarjen e bursave për studentët e Komunës së Drenasit, do ti ndaj 1 (një) bursa për studentët e Komunës së Drenasit.
2. Kompania për një student do ta financoj shumën prej 500 (pesëqind) euro, shuma e financuar në total për një studentë është 500 euro.
3. Bursat do ti ndahen studentëve nga Kompania për vitin akademik 2018/2019.
4. Përmes kësaj burse Kompania synon jo vetëm që studentët e Komunës tonë ti ndihmoj në aspektin financiar por edhe stimuloj në kryerjen e studimeve.

Neni 3
Detyrat dhe përgjegjësitë e Komunës së Drenasit

1. Përpilimin e një liste prej një (1) studenti të Komunës së Drenasit, që i ka plotësuar kriteret e konkursit të datës 05.10.2018, për ndarjen e bursave për studentet e Komunës së Drenasit.
2. Të sigurojë kopjet e llogarive bankare dhe letërnjoftimeve për një studentë dhe do t'i dorëzohen fizikisht "MobileZone" së bashku me një listë, ku në atë listë do të specifikohen: Emri, Emri i Prindit, Mbiemri, Fakulteti, viti i Studimeve, dhe pikët e fituara në bazë të konkursit për ndarjen e bursave.
3. Komuna e Drenasit ka për obligim që "MobileZone" t'i siguroj çdo dokumentacion tjetër që lidhet me një studente, si: Konkursin e datës 05.10.2018 për ndarjen e bursave, nr. e telefonit të studentit si dhe çdo ndihmë tjetër për realizimin e pagesave për studentin.
4. Komuna e Drenasit do të jetë shumë mirënjohës donatorit "MobileZone" për donacionin e dhënë prej një (1) burse për studentet e Komunës së Drenasit.

Neni 4
Zbatimi i Marrëveshjes

1. Palët e kësaj marrëveshje vendosin që zbatimi i saj të koordinohet ndërmjet një përfaqësuesi të caktuar nga Komuna dhe një përfaqësuesi të caktuar nga "MobileZone".
2. Palët e kësaj marrëveshje do të mbajnë kontakte për zbatimin e kësaj marrëveshje, dhe do të njoftojnë njëra-tjetrën me çdo kërkesë, vërejtje, sugjerim a propozim që ka të bëjë me realizimin e kësaj marrëveshje.
3. Nëse Palët vlerësojnë se marrëveshja duhet ndryshohet apo plotësohet nëpërmjet negociatave dhe miratimit me shkrim të ndërsjellë të Palëve.

Neni 5
Hyrja në fuqi

1. Kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi në ditën e nënshkrimit të saj nga Palët.
2. Kjo marrëveshje lidhet për një periudhë njëvjeçare.

Kryetari i Komunës
Ramiz Eladrovci
(nënshkrimi dhe vula)



"MobileZone"

Abdullah Zeneli
(nënshkrimi dhe vula)